



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 737/1 prot.

Tiranë, më 09.07.2021

VENDIM

Nr.94, datë 09.07.2021

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT
TË KOMISIONERIT NR. 77, DATË 21.07.2020**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 77, datë 21.07.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë të aktit nr.27040, datë 29.10.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** dhe mënyrën e zbatimit të tij.”

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 587 prot., datë 6.7.2020, nëpunësi ***** ka parashtruar pretendimin se, transferimi i tij i përkohshëm në pozicionin “Specialist GFI, Sektori i Produkteve Energjitike, Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriori)”, pranë DPD, është bërë në shkelje të kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil që kanë të bëjnë me transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 77, datë 21.07.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë të aktit nr.27040, datë 29.10.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** dhe mënyrën e zbatimit të tij.”

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.77, datë 21.07.2020, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e punës “*Doganier në Sektorin e Kontrollit Aposterior Operativ, Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit, Departamenti Operativo Hetimor*”, në DPD, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është tejkaluar afati maksimal 6-mujor i transferimit, parashikuar në pikën 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar.

Vërej se, në zbatim të dispozitivit të vendimit nr. 77, datë 21.07.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me shkresën nr.11827/1 prot., datë 02.07.2021, ka marrë masa për zbatimin e vendimit paralajmërues. Konkretisht, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin nr.11827 prot., datë 01.07.2021, për rikthimin e nëpunësit civil ***** në pozicionin e mëparshëm të punës bazuar në nenin 48, pika 4, e ligjit nr.152/2013, “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 77, datë 21.07.2020, të Komisionerit, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë të aktit nr.27040, datë 29.10.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** dhe mënyrën e zbatimit të tij.*”
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke zbatuar rekomandimet e vendimit nr.77, datë 21.07.2020

3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha